

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1121/12
(Gjykata Themelore e Prishtinës, P 408/11)

Data: 25 shtator 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister si kryetare e kolegjit e gjyqtare raportuese si dhe nga gjyqtari i EULEX-it Tore Thomassen dhe gjyqtari Vahid Halili si anëtarë të kolegjit, në pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Beti Hohler, si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të akuzuarit

Z.K., të lindur më xxx në fshatin xxx nr. x, komuna xxx Kosovës, me shkollim të mesëm, i martuar, baba i dy fëmijëve, në paraburgim që nga data 07.04.2011;

I akuzuar për kryerjen e veprave penale: *krime lufte kundër popullsisë civile* në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) (Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr. 44/1976, tash e tutje në tekst: KP i RSFJ-së) dhe *mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328 (2) të Kodit Penal të Kosovës (më poshtë: KPK)¹ dhe i shpallur fajtor për dy pika të *krime lufte kundër popullsisë civile* sipas nenit 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së dhe një pikë të *mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328 (2) të KPK-së nga ana e trupit gjykues të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës përmes aktgjykimit nr. P 408/11 të datës 11.05.2012 dhe është dënuar me dënim unik prej 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 500 eurosh;

Duke vendosur rreth ankesave të vazhdim të parashtruara në emër të të akuzuarit Z.K. të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 408/2011 të datës 11.05.2012 (më poshtë: aktgjykimi i kundërshtuar):

- Ankesa e të akuzuarit Z.K., e parashtruar më 13.07.2012,
- Ankesa e avokatit mbrojtës Miodrag Brkljac, e parashtruar më 16.07.2012,
- Ankesa e avokatit mbrojtës Shefki Sylaj, e parashtruar më 17.07.2012,
- Ankesa e avokatit mbrojtës Zivojin Jokanovic, e parashtruar më 17.07.2012,

Pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit special të ndaj ankesave, të parashtruar më 14.08.2012;

¹ Kodi Penal në fuqi nga data 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

Pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës nr. PPA 456/12 të datës 31.10.2012;

Pas mbajtjes së seancës publike më 25.09.2013 në praninë e të akuzuarit Z.K., avokatit të tij mbrojtës Shefki Sylaj, Miodrag Brkljac dhe Zivojin Jokanovic dhe prokurorit të shtetit të apelit Idain Smailji;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 25.09.2013;

Në bazë të nenit 420 dhe atyre në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

sjell këtë:

A K T G J Y K I M

I. Ankesat e mbrojtjes pranohen pjesërisht.

II. Pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 408/11 të datës 11.05.2012, si dhe dispozitat përkatëse lidhur me dënimin, ndryshohen si vijon:

“1. I akuzuari Z.K., me identitetin e përmendur më lart, shpallet fajtor dhe bart përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale të krimeve të luftës ndaj popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, lidhur me nenin e përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës të datës 12.08.1949 dhe nenet 4 dhe 5 (1) të Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të datës 12.08.1949, dhe lidhur me Mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jo brenda shteteve të vitit 08.06.1977, për shkak se

- i) Më ose rreth datës 24 maj 1999, pasi të burgosurit e Burgut të Dubravës ishin transportuar në Burgun e Lipjanit, G.M., së bashku me një numër të burgosurish të tjerë të paignifikuar shqiptarë ishte detyruar të kalonte nëpër mes dy rreshtash të formuar nga gardianë, policë dhe paramilitarë serbë, duke u trajtuar në mënyrë çnjerëzore duke iu shkelur integriteti trupor dhe duke u rrahur nga i akuzuari dhe të tjerët me armë, grushte dhe shkelma, duke marrë lëndime nga të cilat G.M. ka ndërruar jetë diku në periudhën kohore në mes të rrahjes dhe datës 25.05.1999;*
- ii) Më ose rreth datës 24.05.1999, pasi të burgosurit e Burgut të Dubravës ishin transportuar në Burgun e Lipjanit, J.R., së bashku me një numër të burgosurish të tjerë të paignifikuar shqiptarë ishte detyruar të kalonte nëpër mes dy rreshtash të formuar nga gardianë, policë dhe paramilitarë*

serbë, duke u trajtuar në mënyrë çnjerëzore duke iu shkelur integriteti trupor dhe duke u rrahur nga i akuzuari dhe të tjerët me armë, grushte dhe shkelma, duke marrë lëndime.

Sipas nenit 38 dhe nenit 142 të KP të RSFJ-së, Z.K. dënohet me 14 (katërbëdhjetë vjet) burgim.

Sipas nenit 50 (1) të KP të RSFJ-së, koha të cilën i akuzuari e ka kaluar në paraburgim, përkatësisht nga data 7 prill 2011 e këndej, llogaritet në dënim”

ARSYETIM

1. Procedura e gjertanishme

1. Ndodhitë të cilat i kanë paraprirë ngritjes së aktakuzës për *krime lufte kundër popullsisë civile* kanë ndodhur në maj të vitit 1999. Hetimet lidhur me rastin në fjalë kanë nisur në vitin 2011. Më 1 gusht 2011, prokurori special i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), ka ngritur aktakuzën ndaj të akuzuarve pranë (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Kjo aktakuzë është konfirmuar më 26.08.2011 me aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës nr. KA 538/11 me një ndryshim të bërë në një prej pikave të saj. Kjo aktakuzë po ashtu përfshinte edhe akuzën për *mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328 (2) të KPK-së, për të cilën i akuzuari tashmë kishte pranuar fajësinë në seancën e konfirmimit të aktakuzës. I akuzuari nuk kishte pranuar fajësinë lidhur me akuzat për *krime lufte*.

2. Shqyrtimi gjyqësor në procedimin penal është mbajtur para trupit gjykues të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në seancat e mbajtura më datat 01.11.2011, 02.11.2011, 03.11.2011, 17.11.2011, 02.12.2011, 06.12.2011, 10.01.2012, 11.01.2012, 29.03.2012, 30.03.2012 dhe më 08.05.2012. Trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin më 11 maj 2012. Pas shpalljes së aktgjykimit, trupi gjykues po ashtu ka zgjatur edhe masën e paraburgimit ndaj të akuzuarit derisa aktgjykimi të marrë formën e prerë. I akuzuari është duke u mbajtur në paraburgim që nga data 7 prill 2011.

2. Aktgjykimi i kundërshtuar

3. Trupi gjykues ka shpallur të akuzuarin:

- Fajtor për veprën penale *krime lufte kundër popullsisë civile* sipas neneve 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës së datës 12 gusht 1949 dhe me nenet 4 dhe 5 (1) të Protokollit të dytë shtesë të datës 9 qershor 1977, për shkak se më ose rreth datës 24 maj 1999, pasi të burgosurit e burgut të Dubravës ishin sjellë nga burgu i Lipjanit, G.M., së bashku me një numër të burgosurish shqiptarë të paidentifikuar ishte detyruar të kalonte në mes

- të dy rreshtave me gardianë, policë dhe paramilitarë serbë të cilët e kanë trajtuar të pandehurin në mënyrë çnjerëzore duke ia shkelur integritetin trupor dhe duke e rrahur atë dhe të tjerët me armë, me grushte dhe me shqelma, nga të cilat lëndime G.M. ka vdekur diku gjatë periudhës kohore në mes të rrahjes dhe datës 25 maj 1999 (pika 1 e dispozitivit),
- Fajtor për veprën penale *krime lufte kundër popullsisë civile* sipas neneve 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të të katër Konventave të Gjenevës së datës 12 gusht 1949 dhe me nenet 4 dhe 5 (1) të Protokollit të dytë shtesë të datës 9 qershor 1977, për shkak se më ose rreth datës 24 maj 1999, pasi të burgosurit e burgut të Dubravës ishin sjellë nga burgu i Lipjanit, J.R., së bashku me një numër të burgosurish shqiptarë të paidentifikuar ishte detyruar të kalonte në mes të dy rreshtave me gardianë, policë dhe paramilitarë serbë të cilët e kanë trajtuar të pandehurin në mënyrë çnjerëzore duke ia shkelur integritetin trupor dhe duke e rrahur atë dhe të tjerët me armë, me grushte dhe me shqelma, duke i shkaktuar kështu lëndime (pika 2 e dispozitivit),
 - Fajtor për veprën penale *mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328 (2) të KPK-së, për shkak se më 7 prill 2011, në fshatin Dobratin, i akuzuari ka qenë në posedim të një revoleje të llojit Zastava TT, të kalibrit 7.62 mm, me numër serik 1878, të dy karikatorëve dhe të 37 plumbave, të gjitha në gjendje të rregullt, pa leje të vlefshme për mbajtje të armëve (pika 3 e dispozitivit).

4. Gjykata e shkallës së parë e ka dënuar të akuzuarin me 10 vjet burgim për veprën penale sipas pikës 1 të dispozitivit, me 6 vjet burgim për veprën penale sipas pikës 2 të dispozitivit dhe me 500 euro gjobë për veprën penale sipas pikës 3 të dispozitivit. Gjykata pastaj ia ka shqiptuar të akuzuarit dënimin unik prej 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim dhe 500 euro gjobë. Gjykata po ashtu ka llogaritur në dënim të të akuzuarit edhe kohën e kaluar në paraburgim, në mënyrë specifike nga data 7 prill 2011.

5. Mbrojtja ka parashtruar ankesa ndaj aktgjykimit të kundërshtuar lidhur me konstatimin e fajësisë për veprat penale *krime lufte kundër popullsisë civile* (pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar) dhe dënimet e shqiptuara për këto vepra.

6. Mbrojtja nuk ankohet ndaj shpalljes fajtor dhe dënimin lidhur me konstatimin e fajësisë dhe dënimin për pikën 3 të dispozitivit përkitazi me veprën penale *mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve*.

3. Parashtrësat e palëve

7. Vetë i akuzuari dhe tre avokatët e tij mbrojtës kanë ushtruar ankesa të ndara ndaj aktgjykimit të kundërshtuar. Ankesat kundërshtojnë aktgjykimin e kundërshtuar në të gjitha bazat e

parashikuara me nenin 402 (1) të KPPK-së, përkatësisht lidhur me shkeljen esenciale të procedurës penale, shkeljen e ligjit penal, vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe dënimin e shqiptuar.

8. Prokurori special më 14 gusht 2012 ka parashtruar përgjigjen ndaj ankesave të mbrojtjes, duke propozuar që ankesat të refuzohen ndërsa aktvendimi i kundërshtuar të vërtetohet në tërësi.

9. Prokurori i apelit i shtetit në propozimin e vet të parashtruar më 1 nëntor 2012 në bazë të nenit 409 (2) të KPPK-së po ashtu kërkon nga gjykata që t'i refuzojë ankesat si të pabaza dhe ta vërtetojë aktgjykimin e kundërshtuar.

4. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

10. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur rreth ankesave në bazë të neneve 17 dhe 18 të Ligjit për gjykatat.

11. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit për gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

5. Ligji procedural në fuqi – KPPK-ja

12. Gjykata e Apelit e konsideron të udhës të ritheksojë se ligj i zbatueshëm procedural në lëndën penale në fjalë është Kodi (i vjetër) i Procedurës Penale i cili ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.² Në procedimet penale të nisura para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale për të cilat gjykimi tashmë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, zbatohen dispozitat e KPPK-së deri sa vendimi të marrë formë të prerë. Këtu i referohemi dispozitave kalimtare të Kodit të tanishëm të Procedurës penale si dhe mendimit juridik nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në seancën e përgjithshme të datës 23 janar 2013.

6. Ligji material penal në fuqi

13. Shpallja fajtor dhe dënimi i të akuzuarit për veprat penale nën pikat 1 dhe 2 të dispozitivit (akuzat për krime të luftës), bazohet në dispozitat e Kodit Penal të RSFJ-së si ligj i zbatueshëm në kohën kur ishte kryer vepra penale në fjalë.³

² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në fuqi nga data 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

³ Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, dispozita materiale të ligjit penal në fuqi kanë qenë dispozitat e Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të shpallura me ndryshimet e bëra në Rregulloret e UNMIK-ut të përmendura më sipër. Dënimi kapital është shfuqizuar në bazë të nenit 1.5. Sipas nenit 1.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59 për secilën vepër e cila është e dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi me vdekje është shndërruar në dënim me burgim në mes të minimumit të përcaktuar me ligj për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet (40) vjetësh.

14. Kolegji vëren se që nga koha kur pohohet se është kryer vepra penale në fjalë, ligji penal i Kosovës është ndryshuar dy herë. Më 6 prill 2004, ka hyrë në fuqi Kodi i përkohshëm penal i Kosovës i cili ka mbetur në fuqi deri më 31 dhjetor 2012. Më 1 janar 2013, ka hyrë në fuqi Kodi i ri penal i Kosovës, Kodi nr. 04/L-082 (më tutje në tekst: KPRK) i cili aktualisht është ligji penal në fuqi.

15. Në bazë të parimit të përgjithshëm të zbatimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin, të përcaktuar me nenin 2 (2) të KPK-së dhe nenin 3 (2) të KPRK-së, në rast të ndonjë ndryshimi në ligjin në fuqi për një lëndë të caktuar para vendimit të formës së prerë, zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin.

16. Gjykata e Apelit ka analizuar *ex officio* dispozitat e zbatueshme të tri ligjeve për të vërtetuar nëse njëri prej këtyre dy ligjeve të miratuara më vonë është më i favorshëm për të akuzuarin sesa ai në të cilin është mbështetur trupi gjykues. Gjykata gjen se asnjëri prej ligjeve të mëvonshme nuk është më i favorshëm, prandaj zbatohen dispozitat në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

7. Pranueshmëria e ankesave

17. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 11 maj 2012. Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim i është dorëzuar të akuzuarit më 2 korrik 2012, ndërkaq avokatëve të tij mbrojtës si në vijim: avokatit Brkljac më 2 korrik 2012, avokatit Jkanovic më 29 qershor 2012 ndërsa avokatit Syla më 29 qershor 2012.

18. I akuzuari ka parashtruar ankesë më 13 korrik 2012, avokati Brkljac më 16 korrik 2012 ndërsa avokatët Syla dhe Jkanovic më 17 korrik 2012.

19. Ankesat janë parashtruar brenda afatit dhe janë të pranueshme në bazë të neneve 399 dhe 401 të KPPK-së.

8. Gjetjet mbi bazat e ankesave

8.1. Shkeljet e pohuara esenciale të procedurës penale

(a) Shkelja e pohuar esenciale e ligjit procedural në bazë të nenit 403 (1) (2) të KPPK-së, për shkak të dispozitivit të pakuptueshëm, mospërputhjes me bazat e aktgjykimit dhe/ose mungesën e arsyeve

20. Mbrojtja argumenton se dispozitivi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, se arsyetimi nuk i ofron arsyet e plota lidhur me faktet vendimtare në lëndën në fjalë si dhe janë dhënë arsye kontradiktore të cilat nuk mund të përbëjnë arsye për aktgjykim dënues.

21. Kolegji nuk gjen asnjë shkelje të ligjit procedural siç pretendohet nga mbrojtja.

22. Dispozitivi është i pakuptueshëm kur, për shembull, nuk mund të kuptohet se çfarë vendimi ka marrë gjykata, me kënd ka të bëjë ai vendim, cilave vepra penale iu referohet, cili është veprimi penal, si dhe mospërputhje dhe lëshime të ngjashme serioze. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar, nga ana tjetër, është konciz, i qartë dhe përfshin të gjitha elementet e nevojshme, duke përfshirë edhe referimin e dispozitave ligjore në të cilat është mbështetur. Dispozitivi nuk ngre asnjë dyshim përkitazi me atë se çfarë vendimi ka marrë Gjykata Themelore si dhe me cilën veprë penale apo me cilin person ka të bëjë. Po ashtu nuk ekzistojnë dykuptimësi lidhur me dënimin si dhe deklaratimet e tjera në kuadër të aktgjykimit.

23. Dispozitivi po ashtu nuk përputhet me pjesën e arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar. Pjesa e arsytimit paraqet argumentet e trupit gjykues të cilat mbështetin përfundimin e arritur në dispozitiv – konstatimin e fajësisë.

24. Aktgjykimi po ashtu përfshin arsytimin lidhur me faktet vendimtare. Kolegji e pranon se do të ishte ideale sikur arsytimi i Gjykatës Themelore të kishte qenë më i përgatitur, por të meta të tilla nuk arrijnë shkallën e shkeljes esenciale të ligjit procedural. Siç përcaktohet me nenin 403 (1) (2) të KPPK-së, shkelje sipas kësaj dispozite ka vetëm në rastet kur aktgjykimit i mungojnë *të gjitha* bazat apo arsytimi lidhur me *faktet materiale*. Këtu nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë, pasi që në aktgjykimin e kundërshtuar diskutohen të gjitha faktet materiale si dhe arsyet për vendimin e gjykatës.

25. Kolegji vëren se Gjykata Themelore nuk ka nevojë të trajtojë secilën rrethanë apo provë faktike e cila është ngritur në shqyrtimin gjyqësor, por duhet patjetër të fokusohet në faktet kyçe (cilat janë këto fakte kryesore do të varet nga vepra e pohuar penale dhe rrethanat e saj) dhe të tregojë për çfarë arsye i konsideron ato të provuara apo jo.

26. Lidhur me atë se mbrojtja në këtë pikë të ankesës përpiqet ta kundërshtojë arsytimin e Gjykatës Themelore lidhur me vlerësimin e provave përkitazi me gjetjet faktike, kjo gjë do të adresohet nën titullin e vërtetimit gjoja të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

(b) Shkelja e pohuar esenciale e ligjit procedural në bazë të nenit 403(1)10 të KPPK-së, për shkak se aktgjykimi ka tejkalluar akuzën

27. Mbrojtja vlerëson se aktgjykimi i kundërshtuar ka tejkalluar akuzën. Në aktakuzën fillestare të parashtruar më 1 gusht 2011, i akuzuari është pohuar ta ketë privuar nga jeta G.M. Kjo tërësi faktesh nuk është konfirmuar nga ana e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës në aktvendimin konfirmues.

28. Kolegji përsërit edhe një herë se në bazë të nenit 386 (1) të KPPK-së, aktgjykimi mund të lidhet vetëm me akuzuarin dhe me veprën me të cilën merret akuza të cilën e përmban aktakuza.

29. Aktakuza e parashtruar më 1 gusht 2011 përkitazi me G.M. (pika 1) ka pohuar se “i akuzuari “[...] ka privuar nga jeta G.M. , duke ushtruar dhunë mbi të. Në atë mënyrë që më 24 maj 1999, ai e ka rrahur dhe e ka qëlluar me shufër gome, e ka shqelmuar dhe e ka grushtuar në pjesë të ndryshme të trupit, derisa viktima ka mbetur pa vetëdije dhe si pasojë e kësaj, ka vdekur më 25 maj 1999.”

30. Gjyqtari konfirmues në aktvendimin e tij nr. KA 538/11 të datës 26 gusht 2011 ka kufizuar modalitetin e pikës 1 në trajtim çnjerëzor të G.M. . Gjyqtari konfirmues në arsyetimin e tij thotë se “[...] nuk ka dyshim se kryerësi nuk ka vepruar i vetëm. Vetëm duhet të merret parasysh se kontributi i personave të tjerë nuk duhet t’i atribuohet të pandehurit të njohur në fjalë. Kjo është arsyeja pse akuza 1 ndryshohet duke lënë jashtë faktin rëndues të vdekjes së G.M. edhe pse është e qartë se vdekja ka qenë pasojë e trajtimit çnjerëzor të të gjithë kryerësve të pohuar”.⁴

31. Aktakuza pastaj është ndryshuar në shqyrtimin gjyqësor gjatë seancës së parë më 1 nëntor 2011 pastaj përmasat e këtij ndryshimi janë diskutuar deri diku edhe gjatë seancës.⁵ Është e qartë nga procesverbali i asaj seance se prokuroria ka ndryshuar aktakuzën në atë mënyrë duke shtuar se G.M. ka vdekur më 25 maj 1999 si pasojë e rrahjes, dhe duke mos përdorur të njëjtin cilësim juridik si në fillim të vrasjes si modalitetin e pohuar në kryerjen e këtij krimi të luftës.⁶

32. Gjykata Themelore nuk ka tejkalluar aktakuzën. I akuzuari nuk është shpallur fajtor për vrasjen e G.M. . I akuzuari është shpallur fajtor së bashku me persona të tjerë të paidentifikuar se kanë rrahur G.M. dhe e kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore. G.M. ka vdekur si pasojë e këtij trajtimi nga të gjithë kryerësit. Vdekja e tij nuk i atribuohet të akuzuarit, siç pretendohet gabimisht nga mbrojtja. Kjo është e qartë nga dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar si dhe nga pjesa e arsyetimit të tij. Gjykata Themelore ka diskutuar këtë çështje në par. 1.4 të aktgjykimit të kundërshtuar. Gjykata Themelore nuk ka gjetur se veprimet e të akuzuarit kanë qenë shkaktari i vetëm i vdekjes së G.M. , gjë e cila do ta kishte cilësuar veprën si vrasje. Gjykata Themelore vetëm ka gjetur se sjellja e të akuzuarit ka qenë faktor kontribuues.

33. Nga kjo rrjedh se kjo arsye e dhënë në ankesë është e pabazë. Kolegji gjen se Gjykata Themelore ka mbetur në tërësi brenda akuzës së përfshirë në aktakuzë.

(c) Shkelja e pohuar esenciale e ligjit procedural në bazë të nenit 403 (1) (8) të KPPK-së, për shkak se aktgjykimi është mbështetur në prova të pamjaftueshme

34. Mbrojtja në përgjithësi thekson se aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme. Mbrojtja nuk e specifikon se për çfarë prova bëhet fjalë. Megjithatë, pasi që kjo

⁴ Aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës KA 538/11, Gjykata e Qarkut e Prishtinës, i datës 26.11.2011. faqe 5.

⁵ P 408/11, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 1 nëntor 2011, faqe 4 *et seq* (versioni në gjuhën angleze)

⁶ Po aty.

shkelje duhet patjetër të shqyrtohet *ex officio* nga ana e Gjykatës së Apelit në përputhje me nenin 415 (1) të KPPK-së, gjykata me kujdes ka analizuar provat e përmendura në aktgjykimin e kundërshtuar. Gjykata e Apelit nuk gjen se ndonjë prej atyre provave janë të papranueshme. Ankesa në këtë bazë refuzohet.

(d) Shkelja e pohuar esenciale e ligjit procedural në bazë të nenit 403 (2) të KPPK-së, për shkak se trupi gjykues nuk ka zbatuar fare apo gabimisht ka zbatuar një normë procedurale ose janë shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe kjo gjë pastaj ka pasur ndikim apo ka mundur të ketë ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë

35. Ankesa e avokatit mbrojtës Miodrag Brkljac pretendon shkelje të neneve 7 (1) të KPPK-së, 387 (2) të KPPK-së dhe 396 (7) të KPPK-së të cilat sipas nenit 403 (2) të KPPK-së rezultojnë në shkelje esenciale të ligjit të procedurës. Mbrojtja në thelb pretendon se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar në mënyrë të ndërgjegjshme secilën provë veç e veç dhe në raport me provat tjera dhe nuk ka vërtetuar faktet e lëndës në mënyrë besnike dhe të plotë.

36. Kolegji përsërit se do të ishte ideale sikur arsyetimi i Gjykatës Themelore të kishte qenë më i përgatitur, por lëshimet në këtë drejtim nuk arrijnë shkallën e shkeljes së atillë e cila do ta bënte aktgjykimin të kundërligjshëm.

37. Kolegji nuk gjen asnjë bazë në pretendimin e mbrojtjes se Gjykata Themelore nuk kishte vlerësuar provat në mënyrë të ndërgjegjshme. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar iu është adresuar provave, kryesisht provave të dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata Themelore po ashtu iu është adresuar kundërshtive në kuadër të provave dhe ka sqaruar arsyen pse disa prej provave i ka konsideruar më të besueshme se të tjerat. Gjykata Themelore ka shtjelluar arsyen pse nuk është mbështetur në dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e mbrojtjes.

38. Gjykata Themelore po ashtu ka adresuar në mënyrë të qartë dhe të arsyeshme disa çështje të tjera të kontestueshme gjatë procedurës të ngritura nga mbrojtja në ankesa – përkatësisht çështjen e identifikimit të të akuzuarit (par. 3.10 i aktgjykimit të kundërshtuar), peshën e dëshmitarëve të tjerë të prokurorisë lidhur me kontaktin e J.R.t me ta para se të merren në pyetje në shqyrtimin gjyqësor (par. 3.11 – 3.13 i aktgjykimit të kundërshtuar), rëndësia e faktit se J.R. ka paraqitur rastin tek në vitin 2009 (par. 3.9 i aktgjykimit të kundërshtuar).

39. Nga kjo del se Gjykata Themelore *paska* vlerësuar provat veç e veç dhe në raport me njëra tjetrën, prandaj kolegji nuk gjen asnjë shkelje në këtë drejtim.

40. Në pjesën ku mbrojtja e thekson rëndësinë e faktit se J.R. ka kontaktuar dëshmitarët e tjerë, kolegji pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore lidhur me rëndësinë dhe ndikimin eventual të J.R.t kur ka diskutuar për ngjarjet dhe për të akuzuarin me dëshmitarët e tjerë. Gjykata Themelore në mënyrë logjike dhe të arsyeshme ka vlerësuar se më shumë ka pasur mundësi për një rikujtim të përbashkët të ngjarjes sesa rikujtim të ndarë dhe të pavarur. Kjo gjë sipas Gjykatës Themelore ka zbehur aspektin e pavarësisë së disa prej provave duke i dhënë më pak rëndësi

provave identifikuese të këtyre dëshmitarëve. Gjykata Themelore prandaj ka pranuar të metat e këtyre provave dhe me të drejtë ka nxjerrë përfundimet e saj lidhur me rëndësinë e tyre. Argumenti i mbrojtjes rreth ankesës se kjo gjë nuk është marrë parasysht, prandaj është tërësisht i pavend.

41. Ankesa e avokatit mbrojtës Zivojin Jokanovic në pjesën e shkeljes së nenit 403 (2) të KPPK-së duket se ngre çështjen e mënyrës së zhvillimit të intervistës me dëshmitarin kryesor J.R., por nuk e specifikon më tej. Në pjesën ku mbrojtja pohon se *kjo* i ka hapur rrugë shkeljes në bazë të nenit 403 (2) të KPPK-së, refuzohet një argument i tillë.

42. Kolegji vëren se shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë është caktuar të fillojë më 17 tetor 2011 dhe dëshmitari J.R., i cili banon në Gjermani, është ftuar atë ditë që të paraqitet me dëshminë e tij. Megjithatë, ditën kur shqyrtimi gjyqësor ishte caktuar të fillojë, pritej edhe një ankesë ndaj aktvendimit të gjyqtarit konfirmues, kështu që ende nuk ishin plotësuar kushtet për fillimin e shqyrtimit gjyqësor.⁷ Kryetari i trupit gjykues më 17 tetor 2011 ka mbajtur seancën në të cilën kanë prezantuar të gjitha palët, duke përfshirë edhe të akuzuarin dhe avokatin e tij mbrojtës. Seanca është trajtuar si një mundësi e jashtëzakonshme hetimore në bazë të nenit 238 të KPPK-së, dhe dëshmitari J.R. ka dhënë dëshminë e tij. Kolegji vëren se mbrojtja nuk ka pasur kundërshtime ndaj një procedimi të këtillë⁸. Dëshmitari ka dëshmuar në prani të prokurorit, të akuzuarit dhe avokatit të tij mbrojtës. Mbrojtja ka pasur mundësi të plotë të parashtrojë pyetje si për dëshmitarin kështu që edhe dy avokatët mbrojtës edhe i akuzuari kanë bërë pyetje. Deklarata e dëshmitarit është futur në procesverbal në shqyrtimin kryesor.

43. Mbrojtja në fund të argumenteve të paraqitura nga prokuroria ka kërkuar nga kolegji që edhe një herë ta dëgjojë dëshmitarin J.R. me qëllim të sqarimit të provave të tij në raport me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Ky propozim u refuzua nga trupi gjykues.

44. Gjykata e Apelit në këtë drejtim nuk gjen asnjë shkelje të të drejtave të mbrojtjes. Vlen të përmendet se mbrojtja nuk pretendon se nuk i është dhënë mundësia ta marrë në pyetje J.R.n, pohimi i saj është i një natyre tjetër – zaten për shkak të refuzimit të trupit gjykues për ta thirrur edhe një herë J.R.n si dëshmitar, mbrojtja është privuar nga sqarimi i deklaratës së tij në dritën e provave të dëshmitarëve të tjerë. Gjykata e Apelit vëren se përderisa ka kundërshti të pohuara lidhur me ngjarjet nga dëshmitarët e ndryshëm, kjo gjë nuk kërkon dëgjimin e serishëm të dëshmitarëve. Dëshmitari në radhë të parë dëgjohej edhe një herë në rastet kur duhet të merret në pyetje rreth çështjeve për të cilat nuk ka dëshmuar në dëshminë fillestare. Megjithatë, gjykata vëren se në rastet kur ka mospërputhje në mes të deklaratave të dëshmitarëve, një gjë e tillë nuk kërkon që dëshmitarët të ri-dëgjoen. Dëshmitari në radhë të parë dëgjohej sërish në rastet kur është e nevojshme të merret në pyetje rreth çështjeve për të cilat nuk kishte dëshmuar gjatë dhënies së dëshmisë së parë. Megjithatë, kur ka mospërputhje në mes të deklarimeve të

⁷ Ankesa është hedhur poshtë si e paafatshme.

⁸ Shih procesverbalin e mundësisë së jashtëzakonshme hetimore, të datës 17 tetor 2011, faqe 2 (versioni në anglisht).

dëshmitarëve, varet nga gjykata të bëjë vlerësimin se çfarë rëndësie kanë ato mospërputhje si dhe cilat prova, po qe se ka ndonjë, konsiderohen më të besueshme.

45. Trupi gjykues prandaj nuk ka qenë obligim ta dëgjojë edhe një herë dëshmitarin. Trupi gjykues ka vlerësuar se nuk ka nevojë për marrjen e mëtejshme në pyetje të dëshmitarit. Ky vendim ka qenë plotësisht në kuadër të autoritetit të trupit gjykues prandaj Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë shkelje e cila do t'i dëmtonte të drejtat e mbrojtjes në këtë drejtim.

8.2. Vërtetimi gjoja i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike

46. Mbrojtja pohon se Gjykata Themelore kishte vërtetuar gabimisht dhe / ose në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike në lëndën kundër të akuzuarit. Mbrojtja iu referohet ekstrakteve të dëshmive të dëshmitarit të cilat sipas pikëpamjes së tyre nuk janë marrë parasysh dhe kanë çuar Gjykatën Themelore në bërjen e vlerësimeve të gabueshme lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve që pastaj ka rezultuar në konkluzione të gabueshme faktike.

47. Para se të shqyrtohen argumentet individuale të ankesave të mbrojtjes lidhur me vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji përsërit edhe një herë standardin e shqyrtimit të gjendjeve faktike nga trupi gjykues. Neni 405 i KPPK-së përcakton shprehjet “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”. Është e qartë nga këto përkufizime se ankuesi nuk duhet vetëm të tregojë për ndonjë lajthitje të pohuar ose për vërtetim jo të plotë të fakteve por ai vërtetim i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike duhet të ketë lidhje me një “fakt vendimtar”. Me fjalë të tjera, ankuesi duhet patjetër të vërtetojë se vërtetimi i gabueshëm apo vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike është i rëndësishëm jetike për aktgjykimin e marrë.⁹ Rrjedhimisht, vetëm në raste të tilla Gjykata e Apelit e anulon vendimin e trupit gjykues.¹⁰

48. Është parim i përgjithshëm i procedurave ankimore që Gjykata e Apelit duhet domosdo të ketë një lloj respekti ndaj gjetjeve faktike të trupit gjykues për shkak se ky i fundit ka pasur mundësinë më të mirë për të bërë vlerësimin e provave. Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se duhet patjetër “ta respektojë vlerësimin e trupit gjykues të besueshmërisë së dëshmitarëve të gjykatës të cilët janë paraqitur personalisht para saj dhe të cilët personalisht kanë dhënë deklaratimet e tyre. Nuk është e udhës që Gjykata Supreme e Kosovës të shkelë mbi vlerësimin e trupit gjykues rreth besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve nëse nuk e ka ndonjë bazë të fortë për një gjë të tillë.” Standardi të cilin Gjykata Supreme e ka zbatuar ka qenë “të mos prekë në gjetjet e gjykatës përderisa provat në të cilat është mbështetur gjykata të mos jenë pranuar nga ndonjë gjykatë e arsyeshme e cila ka gjykuar lëndën, ose vlerësimi i së cilës ka qenë

⁹ Shih po ashtu edhe B. Petric, në: Komentim i neneve të Ligjit të procedurës penale të Jugosllavisë, botimi i dytë, 1986, neni 366, par. 3.

¹⁰ Kjo qasje tashmë është theksuar nga ana e Gjykatës së Apelit në lëndën PaKr 1122/12, aktgjykimin e datës 25 prill 2013 (shih par. 39 - 40).

plotësisht i gabueshëm".¹¹ Qasja e marrë nga Gjykata Supreme reflekton parimin e procedurave ankimore i cili zbatohet – edhe pse me disa variacione – si në juridiksionet e ligjit anglo-sakson (*common law*) dhe ligjit civil ashtu edhe në procedimet ligjit penal ndërkombëtar (*shih p.sh. Gjykata Supreme e Irlandës, Hay v. O'Grady, [1992] IR 210; Gjykata Federale e Drejtësisë e Gjermanisë, BGHSt10, 208 (210); Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi, prokurori kundër Kupreskic et al., IT-95-16-A, Aktgjykimi mbi ankesat, par. 28 et seq.*).¹²

49. Mbrojtja e parashtron një argument të përgjithshëm dhe të gjerë se dëshmitë e disa prej dëshmitarëve të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor dallojnë nga deklaratat e tyre gjatë hetimeve, dhe se për këtë arsye dëshmitarët në fjalë nuk duhet të trajtohen si dëshmitarë të besueshëm.

50. Fillimisht, duke shqyrtuar me kujdes procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, kolegji vë në dukje se kurdo që gjatë shqyrtimit gjyqësor në çfarë do mënyre ndryshonte dëshmia prej deklaratës së mëhershme të dëshmitarit të njëjtë, dëshmitari është ballafaquar me kundërthëniet dhe është kërkuar sqarim për këtë. E njëjta mënyrë është shfrytëzuar edhe nga prokurori, mbrojtja dhe trupi gjykues dhe, në realitet, nga shumica e dëshmitarëve, deri në një masë, është kërkuar të komentojnë deklaratat e tyre të dhëna gjatë hetimeve dhe të sqarojnë kundërthëniet në përgjigjet e tyre.

51. Ankesa e avokatit mbrojtës Jokanovic merret me çështjen e kundërthënieve në dëshmitë e dëshmitarëve J.R., R. G., F.M. dhe Xheme M.. Kolegji vëren se kundërthëniet e referuara nga mbrojtja janë shoshitur dhe sqaruar gjatë marrjes së dëshmiave në shqyrtimin gjyqësor prandaj kjo nuk ka ndikim në besueshmërinë e provave. Trupi gjykues në mënyrë aktive ka ndjekur çdo kundërthënie relevante dhe ka kërkuar sqarime lidhur me atë se për çfarë arsye të njëjtat kanë mundur të ndodhin, prandaj deklarimi se janë injoruar kundërthëniet është i pabazuar. Kolegji i referohet procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor në seancat kur janë marrë në pyetje këta dëshmitarë gjegjësisht në seancat e datës 01.11.2011 (F. . dhe Xh. M.) dhe 11.01.2012 (R. G.) dhe procesverbali i mundësisë hetuese të jashtëzakonshme të datës 17.10.2011 (J.R.).

52. Ankesat e mbrojtjes duket se pranojnë që rrahjet e G.M. dhe J.R.t kanë ndodhur me datën 24.05.1999 në burgun e Lipjanit.¹³ Theksi i ankesës është në gjetjen se i akuzuari ka marrë pjesë në rrahje. Mbrojtja paraqet se dëshmitë e J.R.t dhe dëshmitarëve të tjerë të prokurorisë nuk janë të besueshme dhe identifikimi i të akuzuarit si pjesëmarrës në rrahje ishte i gabuar.

¹¹ Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30

¹² Gjykata e Apelit, PaKr 1122/12, aktgjykimi i datës 25 prill 2013, par. 40.

¹³ Shih p.sh. ankesa e avokatit mbrojtës Brkljac, f. 5.

53. Kolegji vë në dukje se është e padiskutueshme që G.M. dhe J.R. janë transferuara nga burgu i Dubravës në burgun e Lipjanit më datën 24.05.1999. Njëherazi është e padiskutueshme se i akuzuari ka qenë në punë në burgun e Lipjanit më datën 24.05.1999.

54. Një numër i dëshmitarëve të cilët janë transferuar nga burgu i Dubravës në burgun e Lipjanit së bashku me J.R.n dhe G.M. janë marrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor. Provat e tyre vërtetuan dëshminë e J.R.t në të gjitha faktet përkatëse vendimtare. Prandaj pohimi i mbrojtjes se provat e J.R.t mbeten të pa vërtetuara vazhdon të mbetet jo korrekt.

55. Për shembull, dëshmitarët Xh.M., A. M., S. B., I. P., M. Th., të gjithë kanë dëshmuar se si janë transportuar në burgun e Lipjanit e edhe për trajtimin të cilin e kanë pasur nga rojet e burgut, policia dhe paramilitarët me të arritur në burgun e Lipjanit. Të gjithë dëshmitarët, në mënyrë të vazhdueshme, kanë përshkruar se rojet kanë formuar dy rreshta nga porta e hyrjes së burgut dhe se të burgosurit e Dubravës është dashur të ecin dhe të kalojnë në mes të rreshtave të tyre. Dëshmitarët dëshmuar se gjatë kësaj kohe ata i kanë rrahur duke ecur pas tyre. Dëshmitarët dëshmuar se rojet, policia dhe paramilitarët kanë shfrytëzuar gjësende të ndryshme për t'i goditur të burgosurit – shufra metalike, objekte nga druri, armë.

56. Dëshmitarët Xh.M., H. M., R. G.kanë qenë drejtpërsëdrejti dëshmitar të rrahje së G.M. . Xh. M. ka dëshmuar se një roje e burgut e ka goditur G.M. në shpinë dhe në qafë, se G.M. ka rënë në tokë dhe pas kësaj rënie, roja e ka shkëlluar dhe e ka shtypur me këmbë. Ai ka vërtetuar se kanë qenë më shumë se një person të përfshirë në rrahje.¹⁴ Dëshmitari H. M. ka dëshmuar se ai ka parë përafërsisht 2-3 persona duke e rrahur G.M. me shufra metalike, me hunj, me shufra druri, dhe me kondakë të pushkës AK-47.¹⁵ Ai po ashtu e ka identifikuar të akuzuarin si njërin nga personat i cili e ka rrahur G.M. (shih më poshtë). Dëshmitari më tej ka dëshmuar se ai ka parë G.M. duke u rrëzuar dhe të shtrirë përtokë. Dëshmitari R.G. ka dëshmuar për rrahjen e G.M. dhe të J.R.t. Ai e ka parë G.M. të jetë rrahur në kokë, shpatulla dhe se është lënë pa ndjenja.¹⁶ Dëshmitari M. Th. e ka parë G.M. në qelinë e burgut të Lipjanit dhe ka dëshmuar se G.M. i ka rrjedh gjak nga goja dhe se ka vdekur në mëngjes.¹⁷ Kjo dëshmi përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, të tilla sikurse janë dëshmitë e A. M.¹⁸ dhe M. Th.¹⁹, të cilët ishin në qelinë e burgut së bashku me G.M. para se ai të vdiste.

57. Këto prova janë në pajtim me dhe e plotësojnë njëra tjetrën në të gjitha aspektet materiale. Në pjesën ku ka kundërthënie të imta në mes të dëshmive lidhur me gjatësinë e rreshtave të formuara nga rojet, policia dhe paramilitarët, numri i tyre, pozita e G.M. dhe J.R.t kur kanë qenë

¹⁴ P 408/11, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 01.11.2011, f. 27-28.

¹⁵ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 02.12.2011, f. 6.

¹⁶ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 11.01.2012, f.

¹⁷ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 02.12.2011, f. 25

¹⁸ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 03.11.2011, f. 13.

¹⁹ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 02.12.2011, f. 25.

duke ecur përmes rreshtave të tyre, këto nuk janë elemente vendimtare. Këto dallime të vogla e të cilët lehtë mund të sqarohen nuk i bëjnë provat e këtyre dëshmitarëve më pak të besueshme. Këto ishin ngjarje tronditëse dhe është shumë logjike që dëshmitarët kanë disa kujtime të ndryshme lidhur me hollësitat. Ashtu sikurse disa nga dëshmitarët kanë deklaruar, ata vetë janë përqendruar që të mos lëndohen, kanë qenë të frikësuar dhe prandaj mbajtja mend e gjërave mundë të mos jetë e plotë. Mirëpo ngjashëm me atë çfarë u theksua më parë, provat janë të qëndrueshme në të gjitha aspektet materiale gjegjësisht si ishin rojet, policia dhe paramilitarët të pranishëm atje, si i kanë formuar dy rreshtat përmes të cilëve është dashur të kalojnë të burgosurit dhe si janë rrahur ata përfshirë këtu G.M. dhe J.R.n.

58. Në pjesën ku mbrojtja përpiket të kundërshtojë besueshmërinë e dëshmitarëve të prokurorisë duke deklaruar se si është e mundur që disa të burgosur nuk ishin rrahur, kolegji vëren se për shkak të ardhjes së një numri relativisht të lartë të të burgosurve (dëshmitarët kanë treguar për disa autobusë me të burgosur të ardhur nga Dubrava e të cilët nuk kanë qenë të lënduar), është plotësisht e mundur se disa nga ta nuk kanë qenë të rrahur. Duket sheshazi se ndaj të burgosurve të ndryshëm është ushtruar një nivel i ndryshëm i dhunës për çfarëdo qoftë arsye. Kjo prapë se prapë nuk i bën provat të paqëndrueshme.

59. Kolegji vëren se nuk janë të pazakonshme kundërthëniet e vogla në mes të dëshmive të dëshmitarëve të cilat i thekson mbrojtja. Në fakt, këto kundërthënie të vogla, sipas këndvështrimit të kolegjit, e forcojnë besueshmërinë e dëshmitarëve. Ato janë kujtimet e personave të ndryshëm. Një deklaratë saktësisht e njëjtë lidhur me të gjitha detajet do të ishte më e pazakonshme dhe ka më shumë gjasë të jetë tregues i një marrëveshjeje të fshehtë sesa të jetë kundërthënie në detaje.

60. Kolegji tani kthehet tek çështja e identifikimit të të akuzuarit si person i cili e ka rrahur G.M. dhe J.R.n më datën 24.05.1999.

61. Mbrojtja gabimisht deklarohet se J.R. ishte i vetmi person i cili e ka identifikuar të akuzuarin dhe se aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet vetëm në dëshmitë e këtij dëshmitari të vetëm. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor tregon se provat e J.R.t, në realitet, janë vërtetuar nga një numër i dëshmitarëve të tjerë.

62. Dëshmitari Sali Bytyqi ka deklaruar se ai e ka parë Z.K.in të ketë marrë pjesë në rrahjen e të burgosurve. Ai sqaron se ai e ka parë Kolicin nga distanca pasi që nuk ishte i koncentruar në të por ishte i sigurt se e ka parë në grup duke i rrahur të burgosurit që kishin ardhur.²⁰

63. Dëshmitari Ismet Paçarizi, dëshmisë së të cilit Gjykata Themelore i ka dhënë një peshë të konsiderueshme, nuk ka mundur ta njoh Z.K.in, por ka dëshmuar se ka dëgjuar rojet duke thënë

²⁰ Seanca e datës 03.11., f. 27-28

“Z., mëshoji”.²¹ Z. është nofka e Z.K.it. Kolegji pajtohet me Gjykatën Themelore se kjo deklaratë është vërtetim për saktësinë e identifikimit të të akuzuarit nga ana e J.R.t. Mbrojtja kundërshton deklaratën e P. duke vë në pah se asnjëri nga dëshmitarët e tjerë nuk i ka dëgjuar fjalët “Z., mëshoji” dhe se për këtë arsye Gjykata Themelore është dashur të refuzojë besueshmërinë e deklaratës së Paçarizit. Kolegji nuk pajtohet me këtë. Është plotësisht e mundur dhe e arsyeshme që dëshmitarët kanë mbajtur mend gjëra të ndryshme nga ajo ditë. Dëshmitarët kanë mundur mos ta dëgjojnë këtë apo vetëm kanë harruar se e kanë dëgjuar. Në secilin rast, dëgjimi i këtyre fjalëve vetëm nga I. P. nuk do të thotë se ky dëshmitar i ka sajuar ato sikurse duket që sugjeron mbrojtja. Kolegji nuk gjen asnjë arsye për të dyshuar në besueshmërinë e dëshmitarit P..

64. Më tutje, dëshmitari H. M. ka njohur Z.K.in si personin i cili e ka rrahur G.M. .²² Ai e ka njohur të akuzuarin në gjykatë dhe ka theksuar se e njeh atë mirë nga koha kur ka qenë më parë i burgosur në burgun e Lipjanit. E njëjta vlen edhe për dëshmitarin R. G. i cili po ashtu e ka njohur të akuzuarin si personin i cili e ka rrahur G.M. dhe J.R.n.²³

65. Mbrojtja gjithashtu pretendon se Gjykata Themelore nuk ka marrë parasysh dëshminë e F.l M., i cili ka pohuar se G.M. ishte në gjendje të dobët shëndetësore në burg. Përmes këtij argumenti, mbrojtja me sa duket e kundërshton gjetjen se G.M. vdiq si pasojë e rrahjes. Pohimin e mbrojtjes rreth dëshmisë së F. M., kolegji e konstaton të jetë në kundërshtim me procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. F. M. nuk ka deklaruar se babai i tij ishte në gjendje të dobët shëndetësore; ai në realitet ka dëshmuar se G.M. nuk ka pasur ndonjë problem të madh shëndetësore por se i vetmi problem i tij ishte tensioni i lartë i gjakut.²⁴ Më tutje, dëshmitarët e tjerë të cilët janë burgosur së bashku me G.M. në Dubravë kanë dëshmuar se ai ishte në gjendje të mirë shëndetësore. Dëshmitari Xh. M., për shembull, i cili para se të transferohej në burgun e Lipjanit ka kaluar javën e fundit me G.M. , ka dëshmuar se G.M. ishte në gjendje të mirë, i shëndetshëm, nuk ka pasur ndonjë lëndim dhe nuk është ankuar për shëndet.²⁵ Se G.M. nuk ka qenë asses i lënduar gjatë sulmeve në Dubravë, vërtetohet edhe nga fakti se ai ishte transferuar në Lipjan me autobus për dallim të transportimit me kamion (me të cilin ishin transportuar të burgosurit e lënduar). Ky argument i mbrojtjes prandaj është refuzuar. Kolegji vërteton konkluzionet e Gjykatës Themelore të mbështetura nga dëshmitë e dëshmitarëve se G.M. nuk ka pasur probleme të rënda shëndetësore kur ka arritur në Lipjan dhe se ka vdekur më datën 25.05.1999 si rezultat i rrahjeve të cilat i ka marrë pas arritjes aty.

66. Gjithashtu mbrojtja orvatet ta portretizojë J.R.n si person i cili i ka ujdísur hetimet kundër të akuzuarve. Kolegji nuk ka gjetur asnjë mbështetje për një përcaktim të tillë. J.R. ka sqaruar pse

²¹ Seanca e datës 17.11.2011, f. 6.

²² P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor 02.12.2011. f. 6 (versioni në gjuhën angleze).

²³ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 11.01.2012, f. 4 (versioni në gjuhën angleze).

²⁴ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 01.11.2011, f. 17 (versioni në gjuhën angleze).

²⁵ P 408/11, procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor i datës 01.11.2011, f. 23 (versioni në gjuhën angleze).

e ka paraqitur lëndën penale tek në vitin 2009 dhe Gjykata Themelore ka pranuar shpjegimin e tij si sqarim logjik dhe të arsyeshëm. Kolegji nuk ka bazë për të nxjerr konkluzion ndryshe. Është e paqartë pse J.R. do të sajonte papandehur përfshirjen e të akuzuarit. Kolegji nuk sheh asnjë shpjegim logjik pse ai do ta bënte atë; nuk ka pasur asnjë grindje në mes të dy burrave që do e nxiste Rexhepin në veprime të tilla. Kolegji prandaj refuzon këtë përcaktim të mbrojtjes si tërësisht të pabazuar.

67. Mbrojtja gjithashtu ngrit çështjen e deklaratës së J.R.t në NjHKL (njësia hetimore për krime të luftës) të EULEX - it më datën 24.09.2010.²⁶ Mbrojtja i referohet dëshmitarit i cili përshkruan rojet në burgun e Lipjanit (dhe jo në burgun e Prishtinës sikurse pretendohet në ankesën e mbrojtjes) herën e parë kur është burgosur atje dhe referimit që i bën në Z. dhe K.. Mbrojtja prandaj paraqet se ata ishin dy persona të ndryshëm dhe pretendon se Gjykata Themelore është dashur ta vlerësoj këtë. Kolegji nuk e sheh rëndësinë e këtij argumenti për gjetjet e Gjykatës Themelore. J.R., në realitet, u është referuar rojeve të burgut si “K., Z.K.dhe të tjerët” dhe ai, do të dukej, se u është referuar dy personave të ndryshëm. Megjithatë ajo çfarë është me rëndësi është se dëshmitari pas kësaj përshkruan personin e quajtur Kolic dhe në mënyrë esenciale jep përshkrimin e të akuzuarit. Pas kësaj dëshmitari sqaron se kur ka qenë në Lipjan më datën 24.05.1999, dhe kur ka dëgjuar emrin Kolic atij i është kujtuar se ky ishte i njëjti person të cilin e kishte njohur nga burgu i Lipjanit, d.m.th i akuzuari. Prandaj nga deklarata e J.R.t është e qartë se përshkrimi dhe dëshmia e tij i është referuar të akuzuarit.

68. Në pjesën ku mbrojtja e kundërshton peshën e dhënë identifikimit nga dëshmitarët të të akuzuarit dhe thekson se kur janë pyetur për kryerësin të cilin e kanë parë më datën 24.05.1999 dëshmitarët në mënyrë të pa evitueshme do të tregonin me gisht kah i akuzuari në sallën e gjykatës, një argumentim i tillë është i gabuar dhe i pa bazë. Kolegji vëren se nga dëshmitarët është kërkuar të bëjnë përshkrimin e kryerësit dhe pas kësaj ata janë pyetur nëse personi i pranishëm në sallën e gjykatës ishte ai person. Një numër i dëshmitarëve e kanë konfirmuar se i akuzuari ishte personi për të cilin ata dëshmuuan se e ka rrahur G.M. dhe J.R.n më datën 24.05.1999. Sido që të jetë është e paarsyeshme të pohohet se dëshmitarët do të tregonin me gisht kah i akuzuar thjesht sepse ai ishte i akuzuari i lëndës.

69. Në fund, mbrojtja pohon se edhe Gjykata Themelore në mënyrë të paarsyeshme i ka hedhur poshtë dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes pa i vlerësuar ato siç duhet. Ky pohim është jo korrekt. Gjykata Themelore e ka adresuar dëshminë e dëshmitarëve të mbrojtjes dhe ka sqaruar pse nuk i ka konstatuar dëshmitë e tyre të besueshme. Në paragrafët 3.15 dhe 3.16 të aktgjykimit të kundërshtuar, Gjykata Themelore ka shoshitur dëshmitë e M. D., S. M., M. M. dhe S.Ristic. Kolegji nuk gjen asnjë të metë në vlerësimin e Gjykatës Themelore në lidhje me këta dëshmitarë.

²⁶ Ankesa e avokatit mbrojtës Brkljac.

70. Si konkluzion, kolegji konstaton se Gjykata Themelore ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte faktet në lëndë në lidhje me rrahjet e G.M. dhe J.R.t dhe përfshirjen e të akuzuarit në to. Gjetjet faktike mbështeten nga një bollëk provash, sikurse është përshkruar më sipër.

8.3. Shkelje e supozuar e ligjit penal në pajtueshmëri me nenin 404 të KPPK-së

71. Mbrojtja e kundërshton cilësimin e veprës së dyshuar penale në dy pika. Së pari, ajo paraqet se madje edhe nëse i akuzuari do të ishte i përfshirë në rrahjen e dy burrave shqiptar, ai vetëm do të mundë të ndiqej për tejkalim të autorizimit të tij, dhe jo për krime lufte kundër popullatës civile. Mbrojtja pohon se nuk janë plotësuar elementet të cilat shkaktojnë zbatimin e nenit 142 të KP RSFJ. Si paraqitje shtesë dhe alternative, mbrojtja argumenton se veprimet e të akuzuarit nuk duhet të cilësohen si dy pika të ndara të aktkauzës *Krime lufte kundër popullatës civile* por vetëm si një vepër penale dhe është dashur të shqiptohet vetëm një dënim.

72. Në pjesën ku ka të bëjë me argumentin e parë, kolegji pranon se arsyetimi i Gjykatës Themelore nuk është i kënaqshëm në lidhje me analizën ligjore të elementeve të veprës penale nën nenin 142 të KP RSFJ. Megjithatë kolegji konstaton se konkluzion i Gjykatës Themelore, edhe pse pamjaftueshëm i arsyetuar, është korrekt dhe veprimet e të akuzuarve janë cilësuar në mënyrë korrekt si *Krime lufte kundër popullatës civile*.

73. Dispozita e nenit 142 të KP të RSFJ në pjesën relevante thotë me sa vijon: *kushdo që duke shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, urdhëron që popullata civile të jenë subjekt i [...] trajtimit çnjerëzor, [...] apo që kryen një nga aktet e përmendura [...] .*

74. Me qëllim të përcaktimit nëse veprimet e të akuzuarit përbëjnë një krim lufte, duhet të adresohen këto elemente:

- a ka qenë duke u zhvilluar ndonjë konflikt i armatosur në Kosovë më ose rreth datës 24.05.1999 dhe nëse ka qenë duke u zhvilluar, cilat kanë qenë normat e zbatueshme të cilat e kanë sunduar konfliktin e atëhershëm të vazhdueshëm të armatosur (a ka qenë konflikti i armatosur i natyrës ndërkombëtare apo jo ndërkombëtare),
- a ishin G.M. dhe J.R. persona të mbrojtur nën ligjin ndërkombëtar,
- a ka pasur lidhshmëri në mes të konfliktit të armatosur dhe veprës penale.

75. Në pjesën ku ka të bëjë me ekzistimin e konfliktit të armatosur në Kosovë në atë kohë, kjo është vërtetuar mirë dhe pa mëdyshje përmes jurisprudencës vendore dhe ndërkombëtare. GjNKJ dhe Gjykata Supreme e Kosovës në raste të shumta kanë vërtetuar konfliktin e vazhdueshëm jo ndërkombëtar të armatosur në Kosovë së paku që nga pranvera e hershme e vitit 1998 e më tutje në mes të forcave të armatosura (qeveritare) Serbe dhe UÇK-së i cili ka vazhduar deri në vitin 1999.²⁷ Dhoma e gjykatës të GjNKJ-së në lëndën *Milutinović* dhe *Dorđević* në mënyrë të qartë

²⁷ Shih p.sh. *prokurori v. Milan Milutinović*, GJNKJ, aktgjykimi, 26 shkurt.2009, vëllimi 1 i aktgjykimit, paragrafët 840-841; *prokurori v. Vlastimir Dorđević*, GJNKJ, aktgjykimi, 23 shkurt 2011 para. 1579.

ka konsideruar se konflikti i armatosur ka vazhduar deri në qershor 1999.²⁸ Sa i përket kohës kur ka ndodhur vepra e dyshuar penale, ekzistimi i një konflikti të brendshëm të armatosur në mes të UÇK-së dhe forcave serbe është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në vendimin e *Kolasinac* më datën 5 gusht 2004 dhe në vendimin për *Latif Gashi* të datës 21 korrik 2005.²⁹

76. Vlen të përmendet se mbrojtja nuk e kundërshton ekzistimin e konfliktit të armatosur si të tillë, megjithatë ajo kundërshton ekzistimin e lidhshmërisë në mes të veprës përkatëse penale dhe atij konflikti.

77. Në jurisprudencën e GjNKJ – së, trajtimi çnjerëzor është përcaktuar si “një veprim ose mosveprim i qëllimshëm, që është një akt i cili, gjykuar në mënyrë objektive, është i qëllimshëm dhe jo i rastësishëm, e i cili shkakton dëmtim të rëndë mendor ose vuajtje fizike ose lëndim ose përbën sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor dhe është kryer kundër një personi të mbrojtur.”³⁰ Trajtimi çnjerëzor është përcaktuar në elementet e krimit në gjykatën ndërkombëtare penale si akt i shkakimit të “dhimbjeve të forta fizike ose mendore ose vuajtje ndaj një ose më shumë personave.”³¹

78. Sipas këndvështrimit të kolegjit rrahjet e G.M. dhe J.R.t përbëjnë një trajtim të tillë çnjerëzor. Është vënë në dukje se rrahjet kanë shkakuar vuajtje dhe lëndime fizike substantive.

79. Sa i përket elementit të personave të mbrojtur, edhe G.M. edhe J.R. i takojnë kategorisë së civilëve në kuptim të nenit 142 të KP RSFJ dhe si persona të mbrojtura brenda nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II. Në atë kohë burrat ishin të burgosur dhe nuk kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në konflikte prandaj statusi i tyre si persona të mbrojtur është i pakontestueshëm. Është vënë në pah se të gjithë personat të cilët nuk kanë marrë pjesë drejtpërsëdrejti ose kanë ndaluar të marrin pjesë në konflikte, edhe po që se liria e tyre ka qenë apo jo e kufizuar, kanë të drejtë për t’u respektuar dhe në të gjitha rrethanat doemos duhet të trajtohen në mënyrë të njerëzishme.

80. Kolegji vëren se kuadër të argumenteve të ankesës, një vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet diskutimit të lidhjes në mes të rrahjeve të vërtetuara të G.M. dhe J.R.t dhe konfliktit të zhvilluar të armatosur. Mbrojtja paraqet se nuk ka pasur një lidhshmëri të tillë dhe se rrahjet kanë mundur të përbëjnë vetëm një tejkalim të autorizimit nga ana e të akuzuarit.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (*Kolasinac*), AP-KZ 139/2003, 05.08.2004, f. 14 et seq; vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (*Gashi*), AP-KZ 139/2004, 21.07.2005, f. 9 et seq.

³⁰ *Shih p.sh. prokurori v. Delalic et al (lënda Celebici)*, GjNKJ, aktgjykimi për ankesat 20.02.2001, para. 426.

³¹ Elementet e krimit të GjPI të riprodhuara nga të dhënat zyrtare të asamblesë së palëve shtetërore për statutin e Romës të gjykatës ndërkombëtare penale, seanca e parë, Nju Jork, 3-10 shtator 2002 (United Nations publication, Sales No. E.03.V.2 and corrigendum), pjesa II.B

81. Kolegji pranon se jo të gjitha krimet e rënda të kryera gjatë konfliktit të armatosur përbëjnë krime të luftës. Patjetër duhet të ekzistojë një lidhshmëri në mes të sjelljes penale dhe konfliktit të armatosur. Kushti i lidhshmërisë shërben për të ndarë krimet e luftës nga veprat e përgjithshme penale e po ashtu i parandalon ngjarjet e rastësishme ose të izoluara penale të karakterizuara si krime të luftës.

82. Në përcaktimin e asaj se çfarë e përbën një lidhshmëri të tillë, kolegji zbaton qasjen e miratuar në praktikën e Dhomës së Apelit të GjNKJ –së. Konstatimi i Dhomës së Apelit në *Kunarac* është udhëzues:

*58. Ajo çfarë përfundimisht e dallon një krim të luftës nga një vepër penale e kryer brenda vendit, është se krimi i luftës merr formë ose është i varur nga rrethanat – konflikti i armatosur - në të cilin është kryer. Nuk është e domosdoshme që ai të jetë i planifikuar apo i mbështetur me një politikë të caktuar. **Nuk është e domosdoshme që konflikti i armatosur të ketë qenë shkaktar i kryerjes së kimit, por ekzistimi i një konflikti të armatosur doemos, duhet, së paku, të ketë luajtur rol thelbësor në aftësinë e kryerësit për ta kryer krimin, në vendimin e tij për ta kryer atë, në mënyrën në të cilën është kryer ose qëllimin për të cilin është kryer. Prandaj, nëse kjo mundë të vërtetohet, sikurse është vërtetuar në lëndën aktuale, se kryerësi ka vepruar në përkrahje të ose nën maskën e konfliktit të armatosur, do të mjaftonte të konstatohej se veprimet e tij ishin të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur. Gjetja e Dhomës së Gjykatës lidhur me atë pikë është e pastër.***

59. Në përcaktimin e asaj nëse veprimi në fjalë ndërlidhet ose jo në mënyrë mjaftueshme me konfliktin e armatosur, Dhoma a Gjykatës mund të marrë parasysh, inter alia, këta faktor: faktin se viktimat është luftëtar; faktin se viktimat nuk është luftëtar; faktin se viktimat është anëtar i palës kundërshtare; dhe faktin se krimi i kryer është pjesë e, ose në kontekst të detyrave zyrtare të kryerësit.³²

83. Një krim i luftës mund të ndodhë në një kohë kur dhe në vendin ku luftimi aktualisht nuk është duke u zhvilluar. Në lëndën në fjalë, vepra penale ishte kryer nga një roje burgu në objektin e burgut të drejtuar nga qeveria serbe. Sipas dëshmimeve të disa dëshmitarëve, jo vetëm rojet por edhe pjesëtarët e policisë së Serbisë dhe paramilitarëve kanë marrë pjesë në rrahje. Gjithashtu sipas dëshmisë së dëshmitarëve, dhuna është drejtuar në mënyrë ekskluzive tek të burgosurit shqiptarë. Të burgosurit janë transferuar në Lipjan pas masakrës në burgun e Dubravës. I akuzuari shfrytëzoi pozitën e tij si roje dhe veprimet e tij ishin të drejtuara kundër civilëve të nacionalitetit shqiptar. Sipas këndvështrimit të kolegjit këto veprime në rrethanat e përshkuara renditen në kategorinë e krimeve të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur.

³² GjNKJ, prokurori v Kunarac, lënda nr., IT-96-23&IT-96-23/1-A, aktgjykimi i Dhomës së Apelit, 12.06.2002, paragrafët 58-59. <http://www.icty.org/x/cases/kunarac/acjug/en/kun-aj020612e.pdf>

84. Si konkluzion, kolegji gjen se veprimet e të akuzuarit sikurse janë vërtetuar nga Gjykata Themelore janë cilësuar në mënyrë korrekte në pajtueshmëri me nenin 142 të KP RSFJ si *Krime lufte kundër popullatës civile*.

85. Në lidhje me cilësimin e rrahjeve të G.M. dhe J.R.t si dy vepra të ndara penale, kolegji megjithatë pranon ankesën e mbrojtjes. Kolegji konstaton se veprimet e të akuzuarit sikurse janë vërtetuar nga Gjykata Themelore përbëjnë një veprë penale e jo dy vepra të ndara penale.

86. Nga pikëpamja e kuptimit të përgjithshëm dhe arsytimit logjik, veprimet e inkriminuara të të akuzuarit më datën 24.05.1999 paraqesin një veprimtari, një tërësi të vetme.

87. Kolegji vëren se megjithëse veprat penale të drejtuara kundër integritetit personal përbëjnë, si rregull, vepra individuale penale, vepra penale e *Krime lufte kundër popullatës civile* dhe veprat e tjera kundër njerëzimit dhe ligjit ndërkombëtar janë të ndara në këtë aspekt. Për shkak të natyrës së këtyre veprave penale, ato në përgjithësi do të drejtohen kundër viktimave të shumta. Kjo, ndër të tjera, është e qartë nga formulimi i vet normës penale (neni 142 të KP të RSFJ, neni 153 KPRK). Vepra penale është titulluar *Krime lufte kundër popullatës civile* dhe përgjatë tërë normës shfrytëzohet shumësi, p.sh. “popullata civile subjekt i vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor, ...duke marrë pengje, arrestime të paligjshme ...”.

88. Sipas këndvështrimit të kolegjit, sa herë që veprimet të cilat kanë ndikuar në akuzë mundë të konsiderohen si një ngjarje e përmbajtur, grup i rrethanave, i akuzuari do të ketë kryer një veprë penale të krimit të luftës pavarësisht nga numri i viktimave. Në përcaktimin e asaj nëse vepra penale është për t’u konsideruar si një veprë penale, duhet të merren parasysh kritere të tilla siç është vendi, koha, qëllimi i veprës penale, dashja e kryerësit, marrëdhëniet në mes të veprimeve.

89. Për këtë qasje, kolegji gjen përkrahje në jurisprudencën e rajonit, përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës³³ dhe në jurisprudencës e gjykatës ndërkombëtare penale. Në jurisprudencën e GjNPJ, veprimet kundër më shumë se një viktime, kur janë vërtetuar brenda grupit të njëjtë të rrethanave, janë ndjekur si një pikë e vetme e krimeve të luftës.³⁴

³³ Shih vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Kolasinac), AP-KZ 139/2003, 05.08.2004, f. 6 et seq; Komentari i nenit 173 të Kodit penal të BeH dhe praktika gjyqësore e cituar këtu, Komentari f. 569 et seq (versioni në gjuhën serbe).

³⁴ Shih përmes shembullit p.sh. prokurori v. Jelusic, aktgjykimi i gjykimit të GjNKJ, 14.12.1999, dispozita – vrasjet e Huso dhe Smajil Zahirovic të ndjekura dhe të dënuara si një pikë, duke u shkaktuar lëndim trupor të dy vëllezërve Zejir dhe Reshad të ndjekura si një pikë; prokurori v. Bosksoski dhe Tarculovski, GjNKJ, aktgjykimi i dhomës së gjykatës 10.07.2008, dispozita – vrasje, shkelje e ligjeve ose e zakoneve të luftës, sipas nenit 3 të Statutit, për ndjekjen, planifikimin dhe nxitjen e vrasjes së Rami Jusufi, Sulejman Bajrami dhe Muharrem Ramadani të ndjekur dhe të shpallur fajtor si një pikë, trajtim mizor, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e trajtimit mizor në shtëpinë e Adem Ametovsk të M012, Hamdi Ametovski, Adem Ametovski, Aziz Bajrami, M017, Nevaip Bajrami, Vehbi Bajrami, Atulla Qaili, Beqir Ramadani, Ismail Ramadani, Muharem Ramadani, Osman Ramadani, dhe Sulejman Bajrami; dhe trajtimi mizor në shtëpinë e Braca të M012, Hamdi Ametovski, Adem Ametovski, M017, Nevaip Bajrami, Vehbi Bajrami, Atulla Qaili, Beqir Ramadani, Ismail Ramadani, dhe Osman Ramadani... të ndjekur dhe të shpallur fajtor nën një pikë; etj. Për një pasqyrë të plotë shih praktikën gjyqësore të GjNKJ në të cilën mund të keni qasje përmes www.icty.org.

90. Kolegji gjen se edhe rrahjet e G.M. edhe të J.R.t kanë ndodhur si pjesë e një grupi të rrethanave, të njëjtën ditë, dhe saktësisht në të njëjtin vend, kur janë detyruar të kalojnë me një numër të burgosurve të tjerë të paidentifikuar shqiptarë në mes të dy rreshtave të rojeve serbe të burgut, policisë dhe paramilitarëve dhe kur kanë kaluar në mes tyre, janë rrahur me armë, me grushte dhe shkelma nga i akuzuari dhe kryerësit e tjerë të paidentifikuar. I akuzuari ka vepruar në të njëjtën mënyrë ndaj dy burrave, qëllimi i veprimeve ishte i njëjtë sikurse edhe dashja e të akuzuarit. Në kuadër të kësaj që u tha, veprimet e të akuzuarit prandaj medoemos duhet të cilësohen si një vepër e vetme penale në pajtueshmëri me nenet 22 dhe 142 të KP RSFJ.

91. Kolegji është i vetëdijshëm për qasjen ndryshe të cilën Gjykata Supreme e Kosovës (e cila ka vepruar si Gjykatë e Apelit) e miratoi tek *Gashi* (26.01.2011). Gjykata Supreme në mes tjerash ka dhënë arsyetimin kundër trajtimit të një numri të veprimeve të *Krime lufte kundër popullatës civile* si një “veprim të zgjeruar penal” në pajtueshmëri me nenin 142 të KP RSFJ “sepse kjo do t’i privilegjonte kryerësit dhe në këtë mënyrë do t’u jepte sinjal të gabuar”.³⁵

92. Ky kolegji nuk pajtohet dhe vëren se megjithëse veprimet e të akuzuarit janë cilësuar si një vepër penale, kjo nuk do të thotë se shkalla e përgjegjësisë penale do të jetë e njëjtë për të gjithë kryerësit, përgjegjësia penale e një kryerësi i cili ka kryer veprime të shumta do të jetë më e madhe sesa e një kryerësi i cili ka kryer vetëm një veprim. Numri i veprimeve dhe mënyra e tyre gjithsesi do të ketë ndikim në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe si pasojë edhe në dënimin e shqiptuar. Kryerësi, prandaj, në asnjë mënyrë nuk do të jetë i privilegjuar sepse dënimi i miratuar gjithmonë do të bie, sipas qëndrimit të marrë nga gjykata, në tërësinë e sjelljes penale të të akuzuarit. Më tej, veprimet e ndryshme të cilat kanë ndikuar në cilësim do të duhet që gjithherë të specifikohen si veprime të theksuara në dispozitiv.

93. Në përputhshmëri me arsyetimin më sipër, kolegji ndryshon cilësimin ligjor të aktgjykimit të kundërshtuar në atë mënyrë që shpall të akuzuarin fajtor për një pikë të *Krime lufte kundër popullatës civile* në pajtueshmëri me nenet 142 të KP RSFJ dhe 22 të KP RSFJ. Rrjedhimisht dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është ndryshuar.

9. Pretendimet në lidhje me dënimin

94. Pas vërtetimit të shkeljes së ligjit penal në pajtueshmëri me nenin 404 të KPPK-së në atë se Gjykata Themelore gabimisht ka cilësuar veprën penale si dy vepra të ndara penale të *Krime lufte kundër popullatës civile* në vend se ta cilësojë si një vepër penale, dënimi i dhënë gjithsesi është dashur të rishikohet nga Gjykata e Apelit. I akuzuari duhet të dënohet pikërisht për këtë vepër penale me një dënim brenda kufijve të paraparë me KP RSFJ.

³⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 89/2010, 26.01.2011, f. 28.

95. Kolegji konstaton se dënimi i duhur për këtë veprë penale është 14 (katërmbëdhjetë) vjet burgim. Ky dënim korrespondon me dënimin unik të shqiptuara nga Gjykata Themelore. Kolegji vë në dukje se ky dënim tregon shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe ka parasysh numrin e veprimeve të cilat kanë ndikuar në dënim dhe mënyrën në të cilën është kryer vepra penale.

96. Kolegji konstaton se Gjykata Themelore sipas rregullave ka pasur në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësues dhe rënduese, e të cilat janë marrë parasysh edhe nga Gjykata e Apelit. Kjo e fundit vë në pah se megjithëse veprimet e të akuzuarit janë cilësuar në mënyrë të duhur si një veprë penale e jo si dy vepra penale, sjellja e theksuar penale dhe përgjegjësia penale të cilat kanë pasur ndikim në dënim mbeten të njëjta dhe nuk është ndryshuar nga kolegjit i apelit. Për këtë arsye, kolegji e konstaton të duhur të shqiptoj dënimin në të njëjtën kohëzgjatje.

97. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Aktgjykimi i arsyetuar u kompletua më datën 21.01.2014.

Kryetarja e kolegjit

Annemarie Meister

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Tore Thomassen

gjyqtar i EULEX - it

Anëtari i kolegjit

Vahid Halili

gjyqtar

Procesmbajtësja

Beti Hohler

zyrtare ligjore e EULEX -it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 1121/12

25.09.2013